Në IKSHPK u shënua Dita Botërore e HIV/AIDS-it

Prishtinë 30 nëntor, 2018

Në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike u shënua Dita Botërore e HIV dhe AIDS, nën moton “Dije gjendjen tënde”.

Me këtë rast u tha se HIV dhe AIDS vazhdon të konsiderohet si çështje me prioritet në SHP, në nivel global, dhe se pandemia globale e HIV AIDS-it nuk ka shtrirje të barabartë në botë; prevalenca, incidenca dhe mortaliteti reflektojnë pabarazitë socio-ekonomike dhe shëndetësore në mes të vendeve të zhvilluara, dhe atyre në zhvillim.

Drejtori ekzekutiv i IKSHPK-së, Prof. Dr. Naser Ramadani tha se Instituti Kombëtar duke qenë institucioni më i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor i Kosovës, në shëndetësinë publike, e përcjell në vazhdimësi situatën epidemiologjike me HIV dhe AIDS dhe merret me parandalimin e HIV-it.

“Instituti Kombëtar, tashmë ka përfunduar dy hulumtime nga fusha e HIV/AIDS: “Mapingu programor dhe vlerësimi i madhësisë së popullatave kyçe në Kosovë, 2016”, dhe “Hulumtimi i shpejtë kualitativ për vulnerabilitetin specifik të komunitetit RAE, në lidhje me HIV infeksionin dhe AIDS-in në Kosovë-të përkrahura nga Projektet e Fondit Global në Kosovë, ndërsa sivjet ka prezantuar hulumtimin e katërt me radhë “Mbikëqyrja biologjike dhe e sjelljeve, në mesin e personave që injektojnë

drogë, meshkujve që bëjnë seks me meshkuj, dhe femrave punëtore të seksit në Kosovë, për vitin 2017”, tha mes të tjerash, Prof. Ramadani.

Zv. Ministër i Shëndetësisë, Dr. Ali Berisha tha se Ministria e Shëndetësisë do të vazhdojë të përkujdeset, që të prekurve nga HIV dhe AIDS, t’u sigurohet edhe më tej, terapia antiretrovirale, me qëllim të trajtimit të tyre gjithëpërfshirës, duke rritur në të njëjtën kohë, shërbimet e diagnostikimit, si një hap i rëndësishëm, në parandalimin dhe zbulimin e hershëm të HIV dhe AIDS-it.

Ndërsa, u shpreh se Qeveria e Kosovës gjatë këtij mandati, ka shtuar fokusin për shëndetësi, dhe se edhe vitin që vjen, buxheti për këtë sektor, sipas tij do të jetë dukshëm më i rritur.

Menaxhere e HIV/AIDS FG CDF, Dr. Edona Deva tha programi i Fondit Global për HIV, kontribuon në zbatimin e Planit strategjik nacional për HIV/AIDS 2018-2022, ka themeluar dhe ka fuqizuar shërbimet bazike për parandalimin e HIV-it, si: zvogëlimi i dëmit te PDI, pakot bazike parandaluese te MSM, testimi për HIV, programi i terapisë mbajtëse me metadon, si dhe ka kontribuar në fuqizimin e Asociacionit të personave që jetojnë me HIV, duke u përkujdesur për trajtimin e mirëfilltë, koordinimin e kujdesit dhe përkrahjen e tyre.

Ajo u shpreh se qëllimi i grantit për 2018-2020 është: të mbahet prevalenca e ulët e HIV-it në mesin e popullatës së përgjithshme dhe popullatave kyçe, si dhe të përmirësohet cilësia e jetës së personave të afektuar nga HIV dhe AIDS në

Kosovë.

Shefe e Njësisë për HIV/AIDS, Dr. Luljeta Gashi prezantoi situatën me HIV në Kosovë, ku raportoi se Kosova klasifikohet si vend me shkallë të ulët të epidemisë, por me potencial të rritjes, posaçërisht në mesin e popullatës MSM (meshkuj që bëjnë seks me meshkuj).

“Rasti i parë me AIDS në vendin tonë, është raportuar në vitin 1986, prej këtij viti deri në vitin 2018 në Kosovë janë raportuar 119 raste të HIV dhe AIDS-it. Prej tyre 71 janë me AIDS dhe 48 me HIV infeksion. Ndërsa deri më tani, 47 kanë vdekur si pasojë e AIDS-it”, tha mes të tjerash ajo.

Ndërkaq, për nder të kësaj Dite, me 1 dhjetor në qytet do të shpërndahen materiale edukativo-shëndetësore dhe prezervativë për qytetarët e rastit.

Në IKSHPK u shënua Dita Botërore e Diabetit

Prishtinë, 14 nëntor 2018

Në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës u shënua Dita Botërore e Diabetit, nën moton “Diabeti dhe

familja”.

Me këtë rast u tha se arsyeja e shënimit të kësaj dite është thirrje për aksion për gjithë ata që me kontributin e tyre do të përkrahin masat e parandalimit dhe kontrollit të diabetit, në Kosovë dhe botë.

Drejtori ekzekutiv i IKSHPK-së, Prof. Dr. Naser Ramadani tha se në mbarë botën 425 milionë të rritur jetojnë me diabet dhe ky numër pritet të rritet në 642 milionë. Sa i përket regjistrit populativ për sëmundje kronike jo-ngjitëse, ai tha se kjo ka filluar të stabilizohet në vitin 2017, prandaj nga ky regjistër kanë të dhëna vetëm për vitin 2017.

“Faktorët e rrezikut që favorizojnë shfaqjen e diabetit janë: trashëgimia, apo personat me histori familjare, moshat mbi 40 vjeç, obeziteti dhe mbipesha, mungesa e aktivitetit fizik, duhanpirja, tensioni i lartë i gjakut etj“, tha mes tjerash Prof. Ramadani.

Zv.Ministër i Shëndetësisë, Dr. Rrustem Musa, tha se Dita Botërore e Diabetit shërben për të punuar së bashku në ngritjen e vetëdijes publike për diabetin, por edhe në funksion të mobilizimit të të gjithëve në parandalimin dhe ballafaqimin me këtë sëmundje, që sipas tij ka implikime të mëdha shëndetësore, sociale dhe ekonomike, duke marrë parasysh edhe barrën e shpenzimeve për trajtimin, dhe pasojat e tjera që diabeti i shkakton.

“Ministria e Shëndetësisë do të jetë e përkushtuar që të vazhdojë të ofrojë përkrahje, për pacientët e prekur me diabet, dhe gjithashtu për profesionistët që merren me trajtimin e kësaj sëmundjeje, duke fuqizuar kapacitetet ekzistuese dhe duke krijuar kapacitete të reja, me qëllim të parandalimit të sëmundjes së diabetit, që do të kishte impakt të drejtpërdrejtë, në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe mirëqenies së popullatës”, tha ai.

Sa i përket mbulimit dhe trajtimit të diabetikëve me terapi, sipas tij Ministria e Shëndetësisë ka disa vite që ka krijuar Regjistrin e pacientëve insulinë-vartës, që ka rreth 12 000 pacientë, për të cilët sigurohet insulina dhe barnat e tjera anti-diabetike.

Drejtoresha e Klinikës së Endokrinologjisë, Dr. Venera Berisha u shpreh se bazuar në punën e përditshme në Klinikën e Endokrinologjisë, por edhe në Qendrat e Mjeksisë Familjare në tërë Republikën e Kosoves, trendi i rritjes së sëmundjes së diabetit tip 2, është shumë i madh.

Lidhur me këtë, ajo tha se kjo formë e diabetit mund të parandalohet në shumicën e rasteve, përmes aktivitetit të rregullt fizik, një diete të shëndetshme dhe promovimit të mjediseve të shëndetshme të jetesës.

“Prej muajit shtator 2018, falë ndërtimit të ndërtesës së re të shërbimeve ambulantore, Klinika Endokrinologjike ofron shërbime në dy ambulanca specialistike, me kapacitet të dyfishuar, në raport me më herët, dhe ofron shërbimin më kualitativ të një numri të pacientëve për 50% më të lartë, se muajt e mëparshëm”, tha Dr. Berisha.

Përfaqësuese e Kujdesit Parësor Shëndetësor, Dr. Shpresa Krasniqi përmendi sfidat me të cilat ballafaqohen ata si Kujdes Parësor Shëndetësor, të cilat janë: furnizimi i rregullt me medikamente dhe me insulina, funksionalizimi i Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH), që do të mundësonte kontaktin akoma më të mirë me QKUK si shërbim terciar, mungesa e resurseve humane, si dhe aktivizimi dhe ushtrimi i funksionit të rregullt të Shoqatës së pacientëve me diabet, që duhet të përkrahet nga të gjitha institucionet relevante.

Ndërkaq, në kuadër të shënimit të kësaj dite do të ketë aktivitete të shumta si: mesazhet në radio, si dhe manifestimet në rrugë ku do të bëhet shpërndarja e materialeve edukativo-shëndetësore për kalimtarët e rastit dhe do të matet

sasia e sheqerit në gjak.

Ndotja e ajrit është e lartë në Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Drenas

14 Nëntor 2018

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike po përcjell në vazhdimësi nivelet e larta të ndotjes së ajrit në Kosovë e veçmas në Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë dhe Drenas e sipas .të dhënave të Agjensionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës janë mbi vlerat e lejuara. (web: ammk-rks.net).
Efektet afatshkurta të aerondotjes nga partikulat sipas shumë të dhënave na çojnë drejt rritjes së numrit të vdekjeve të parakohshme, të sëmurëve me astmës bronkiale, bronkitet kronike, sëmundje kronike obstruktive të mushkërive tek moshat e shtyera, rritjen e numrit të pranimeve spitalore nga sëmundjet kardiovaskulare dhe ato respiratore, kancer, shkurtimin e jetës dhe rritjes e shkallës së mortalitetit.

Si burime potencialisht ndotëse tashmë të njohura janë termocentralet elektrike, përdorimi i ngrohjes në sezonën e dimrit, automjetet e vjetëruara dhe trafiku i dendur, djegja e shtuar e karburanteve dhe lëndëve të ngurta djegëse, djegja e mbeturinave, mungesa e sipërfaqeve të mjaftueshme gjelbëruese, mos pastrimi i rrugëve, ndërtimet gjatë tërë vitit pa plan të mirëfillt urbanistik, prania enorme e pluhurit në qytet.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka themeluar në qershor Komitetin Shtetëror ndërministror për Shëndetin Mjedisor për të bërë vlerësimin e ndikimit mjedisor në shëndet në nivel vendi për të hartuar dokumentin strategjik afatgjatë lidhur me adresimin e mirëfilltë dhe efikas të çështjeve të shëndetësisë kosovare që rrjedhin si rezultat ndikimit të mjedisit në shëndet të popullatës; të përgadis Planin e veprimit asfatgjatë dhe planin njëvjeçar për adresimin e ndikimeve mjedisore në shëndet si dhe të realizojë aktivitetet që janë paraparë me këtë plan; të identifikojë normat dhe standardet ndërkombëtare për zbatimin e sigurt të programeve të ndryshme dhe aktiviteteve; identifikimi i ngjashmërive dhe veprimeve mes politikave shtetërore për shëndetin mjedisor dhe politikave shëndetësore në këtë fushë; të bëjë vlerësimin e legjislacionit për shëndetin mjedisor bashkë me rregulloret dhe Udhëzimet administrative; identifikimi i mekanizmave rajonal për bashkëpunim për shëndetin mjedisor; të përcaktojë metodologjinë e nevojshme për të siguruar monitorimin e aktiviteteve të shëndetit mjedisor; të propozojë struktura administrative që do të merren me problemet për shëndetin mjedisor.

A. Duke analizuar situtën aktuale Instituti Kombëtar, propozon këto masa spcifike

1. Inspektorati shëndetësor të kontrolloj raportimin ditor të sëmundjeve respiratore dhe kardiovaskulare nga të gjitha institucionet shëndetësore të kujdesit parësor, dytësor dhe tretësor (veçanërsiht QKMF Prishtinë dhe Klinika Emergjente, SHSKUK).
2. Inspektoratet e mjedisit të bëjnë kontrollin rigoroz të filtrave të ajrit në termocentrale gjatë 24 orëve, kualitetit të karburanteve dhe konsumimit të lëndëve të ngurta djegëse që përdoren për ngrohje nga qytetarët.

3. Shtimi i numrit të autobusëve me karburante ekologjike në transport publik.
4. Të kufizohet ardhja e veturave nga periferia në kryeqytet.
5. Urgjentisht të merren masa rigoroze të kontrollit teknik të veturave.
6. Mirëmbajtja e rrugëve dhe menaxhimi i drejtë i mbeturinave të ngurta.
7. Matja e përhershme e ndotjes së ajrit në pikat kyqe në Kosovë dhe paraqitja ditore e rezultateve online.

B. Masa individuale (rekomandime shëndetësore për popullatën)

1. Të redukohen daljet në qytet dhe ne vendet me ajër të ndotur sidomos në mëngjes dhe mbrëmje e sidomos personat që kanë sëmundje kronike të sistemit kardiovaskular dhe respirator, fëmijët dhe shtatzënat;
2. Qëndroni në shtëpi dhe mos i hapni dritaret për aerosjen e dhomave.
3. Personat që pashmangshëm duhet të dalin në aktivitetet e tyre jashtë shtëpisë të përdorin maska mbrojtëse ose të mbulojnë gojën e hundën me shall.
4. Të redukohet pirjen e duhanit jashtë ku ka qarkullim të njerëzve, e domosdoshmërisht ndalimi i duhanpirjes brenda hapsirave të banimit, punës, shkollave dhe spitaleve.
5. Grupet e popullatës së rrezikuar të tilla si me sëmundje kronike pulmonare, zemrës, pacientët astmatik dhe të prirur për alergji, të moshuarit, fëmijët e vegjël, gratë shtatzëna rekomandohet që të kalojnë më shumë kohë në mjedise me nivele të ulëta të ndotësve, të tilla si malet dhe vendpushime të shëndetshme.

Ekspertët e Institutit Kombëtar paralajmërojnë dhe alarmojnë

se poqese nuk merren masa urgjente, do të ketë efekte negative në dëmtimin e shëndetit dhe rritja e vdekshmërisë nga të gjitha shkaqet e sidomos nga sëmundjet kardiovaskulare dhe respiratore do të jetë shqetësuese.

Takimi në Korçë

Takim i zhvilluar për të diskutuar përgjigjen e shpejtë ndaj ngjarjeve ndërkufitare dhe shpërthimeve të ndryshme, me specialistë të shëndetit publik të fushave të sigurisë njerëzore, veterinare dhe të sigurisë ushqimore nga Maqedonia, Kosova, Greqia dhe Shqipëria.

👉 Drejtorë të Instituteve të Shëndetit Publik përkatësisht Shaban Mehmeti, Naser Ramadani, Theofilos Rosenberg dhe Albana Fico së bashku me specialistë të ndryshëm nga Korça, Pogradeci, Ohri, Struga, Dibra, Shkupi, Prishtina, Kukësi, Tropoja, Gjakova, etj dakorduan veprimet për adresimin e ngjarjeve ndërkufitare që cënojnë shendetin publik. ?
?? ?? ?? ??


ND HOTEL


RAND HOTEL
PALA


GRAND HO
PALAC




Data collection tool

